



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Komisioneri

Nr. 1575/4 Prot.

Tiranë, më 6/12/2013

**Lënda:** Rekomandim për "Vetëm", Tiranë

**REKOMANDIM**

Nr. 45, datë 06/12/2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit,

**KONSTATOVA**

Nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, "**Vetëm prona.com**", Tiranë me objekt:

Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave "klient":

- Mënyrat e mbledhjes, regjistrimit, përpunimit të të dhënave;
- Mjaftueshmërinë dhe proporcionalitetin e përpunimit të këtyre të dhënave përkundrejt qëllimit;
- Plotësimi i detyrimit për të njoftuar.

**Nga kontrolli administrativ u konstatua se:**

Konstatohet se kontrolluesi Agjenci Imobiliare "Vetëm prona.com" ka në administrim një faqe *vetemprona.com* e cila është aktive dhe ofron aktualisht dy shërbime. Shërbimi kryesor konsiston në shtimin e një njoftimi për shitje apo dhënie me qerra të një prone. Personi i interesuar plotëson të dhënat e kërkuara nga forma e regjistrimit. Mund të vendosen për kontakt, adresa email ose nr. telefonit, si dhe të ngarkohen në faqe (server) foto të pronës. Ky njoftimi i plotësuar behet më pas i dukshëm në faqe, nëse miratohet nga administratori i saj. Shërbimi i dytë është abonimi për të marr informacion mbi njoftimet e reja. Personi i interesuar vendos vetëm adresën email të tijën dhe njoftimet do i vinë në këtë adresë. Serveri ku hostohet (mbahet) faqja dhe të dhënat që ngarkohen në të ndodhet në Slloveni. Faqja në gjuhën shqipe është një përkthim i pjesshëm i versionit slloven të saj. Nuk ka probleme me sigurinë e të dhënave, por mungon publikimi i politikës së privatësisë së faqes e cila duhet të përmbajë kushtet e përdorimit dhe menaxhimin e të dhënave "cookies" – informacion i cili në versionin slloven të faqes ishte i publikuar.

Klientët të cilët aplikojnë në sistem nuk japin pëlqimin e tyre të shprehur përpara se të bëhen pjesë e kësaj faqe si dhe nuk informohen paraprakisht për qëllimin e përpunimit të të dhënave të tyre gjë që bie ndesh me nenin 6 pika 1 dhe nenin 18 pika 1 e Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Per mbrojtjen e të dhënave personale” .

U konstatua gjithashtu se subjekti nuk ka kryer detyrimin për njoftim pranë Komisionerit pasi mendon ta mbylli këtë faqe për arsye financiare.

Komisioneri konstaton se kontrolluesi në faqen zyrtare në internet nuk ka të publikuar “politikat e privatësisë”, që janë një paketë rregullash të cilat kanë si qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit. Këto politika ndikojnë në sensibilizimin e publikut mbi rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe të drejtat që gëzojnë në këtë fushë.

**Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi pretendimet e kontrolluesit si dhe provat e administruara vëren se:**

- Nga kontrolli administrativ i ushtruar rezulton se kontrolluesi Agjenci Imobiliare “Vetëm prona.com” nuk e ka plotësuar detyrimin për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- Nuk merret pëlqimi i shprehur nga klientët në lidhje me mbledhjen, regjistrimin, përhapjen, përpunimin e të dhënave të tyre personale përpara se ata të hedhin të dhënat e tyre në faqen online të kontrolluesit në zbatim të nenit 6 pika 1 gërma “a” të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Kontrolluesi nuk informon në mënyrë të qartë e të shprehur për qëllimin e përpunimit, mbledhjes të të dhënave personale të klientëve në përputhje dhe zbatim të nenit 18 pika 1) të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

**Konstatimet e sipërme përbëjnë shkelje administrative të:**

- **Neni 6 pika 1a) i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**  
*“ Të dhënat personale përpunohen vetëm: a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin”.*
- **Neni 18 pika 1) të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”**  
*“kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin.....”.*
- **Neni 21 pika 1 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**  
*“Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës....”.*

Për sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

### REKOMANDOJ

- 1- Në zbatim të nenit 21 i Ligjit Nr. 9887 datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” të përmbushi detyrimin ligjor për plotësimin e Formularit të njoftimit brenda 3 (tre) ditëve punë kalendarike.
- 2- Të merret pëlqimi i shprehur nga klientët në lidhje me mbledhjen, regjistrimin, përhapjen, përpunimin e të dhënave të tyre personale duke u përfshirë si pikë e veçantë në portalin online të kontrolluesit në zbatim të nenit 6 pika 1 gërma “a” të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- 3- Kontrolluesi të përfshijë në portalin online një pikë të veçantë ku të informoj në mënyrë të qartë e të shprehur për qëllimin e përpunimit, mbledhjes të të dhënave personale të klientëve në përputhje dhe në zbatim të nenit 18 pika 1) të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- 4- Në faqen zyrtare në internet duhet të publikohen “politikat e privatësisë” (paketë rregullash) me qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale/sensitive, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. Politikat e privatësisë synojnë sensibilizimin e publikut mbi rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe të drejtat që gëzojnë në këtë fushë.
- 5- Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të kryhet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij rekomandimi.
- 6- Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- 7- Me kalimin e këtij afati në rast mospërmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit *“Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”*.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

**KOMISIONERI**

**Flora CABEJ (POGAÇE)**

